

# PROTOKOLLI

## PËR ZBATIMIN E MASAVE PËR MBROJTJE NGA KOVID -19 NË GJYKATA

Protokolli i cili u miratua nga Shoqata e Gjyqtarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, është me karakter këshillues dhe synon të ndihmojë kryetarët e gjykatave në punën e tyre të përditshme. Zbatohet për gjyqtarët dhe personelin tjetër të gjykatës, si dhe për të gjitha palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurat gjyqësore dhe i njëjti do të zbatohet deri në fund të pandemisë së shkaktuar nga virusi KOVID-19.



### TEMPERATURA E TRUPIT

Nuk do t'i lejohej hyrja në godinën e gjykatës personave, temperatura e të cilëve gjatë matjes në hyrje të gjykatës shënon mbi 37.3°C.



### MASKË MBROJTËSE

Mbajta e maskës higjienike, e vendosur në mënyrë të rregullt në fytyrë është e domosdoshme për të gjithë ata të cilët ndodhen në godinën e gjykatës.



### DISTANCA SOCIALE

Në të gjitha hapësirat e godinës së gjykatës është e detyrueshme të mirëmbahet distanca sociale, d.m.th. mbajta e distancës prej të paktën 2 metra ndërmjet dy personave.



### MJETET PËR DEZINFETIM

Në hyrjet e godinës së gjykatës dhe sallat e gjykimit vendosen dezinfektues që përmbajnë të paktën 70% alkool, me shenjë dezinfektimi i detyrueshëm i duarve dhe këpucëve.



### KOMUNIKIMET ELEKTRONIKE

Palët inkurajohen nëse kanë kushtet teknike për të përdorur WEB portalet e gjykatës, të regjistruhen dhe paraqesin të dhënat e tyre në mënyrë elektronike ose me postë.



### AJROSJA DHE DEZINFETIMI

Detyrueshëm të bëhet ajrosja e vazhdueshme e të gjitha hapësirave në mënyrë të natyrshme (duke hapur dritaret) dhe dezinfektimi i sipërfaqeve të punës me dezinfektues.

### 1. HYRJA NË NDËRTESËN E GJYKATËS

- mbajta e detyrueshme e distancës që duhet të jetë së paku 2 metra midis dy personave;
- dezinfektimi i detyrueshëm i duarve nga pajisja e vendosur në hyrje të godinës;
- mbajta e detyrueshme e maskës mbrojtëse higjienike, e vënë në mënyrë të rregullt në fytyrë;
- matja e detyrueshme e temperaturës së trupit me termometër pa kontakt;
- kalimi i detyrueshëm i inspektimit të sigurisë përmes detektorit nga metali;
- paraqitja e detyrueshme në policinë gjyqësore me dokument personal të identifikimit;

### 2. HAPËSIRAT E PRITJES, KORRIDORET, SHKALLËT DHE ASHENSORËT

- mbajta e detyrueshme e distancës duhet të jetë së paku 2 metra midis dy personave;
- mbajta e detyrueshme e maskës mbrojtëse higjienike, e vënë siç duhet në fytyrë;
- përdorimi i detyrueshëm i ashensorëve me kapacitet të reduktuar (deri në dy persona);
- ajrosja e detyrueshme e hapësirave në mënyrë të natyrshme dhe dezinfektimi i sipërfaqeve të punës;

### 3. DEPARTAMENTI I REGJISTRIMIT DHE PRANIMIT

- mbajta e detyrueshme e maskës mbrojtëse higjienike, e vënë në mënyrë të rregullt në fytyrë;
- numri i palëve duhet të jetë në përputhje me madhësinë dhe kapacitetin e hapësirave, gjë që mundëson mbajtjen e distancës, e cila duhet të jetë së paku 2 metra midis dy personave;
- Ndalohet hyrja dhe kohëzgjatja e panevojshme në sportelet e regjistrimit dhe hapësirat e pritjes;
- ajrosja e detyrueshme e lokaleve në mënyrë të natyrshme dhe dezinfektimi i sipërfaqeve të punës;

### 4. SALLAT E GJYKIMIT

- dezinfektimi i detyrueshëm i duarve nga pajisja e vendosur në hyrje të sallës së gjykimit;
- vënia e detyrueshme e maskës mbrojtëse higjienike, e vënë në mënyrë të rregullt në fytyrë;
- ajrosja e detyrueshme e sallave të gjyqit gjatë ose pas çdo gjykimi, në mënyrë të natyrshme dhe dezinfektimi i sipërfaqeve të punës;
- numri i palëve duhet të jetë në përputhje me madhësinë dhe kapacitetin e sallës së gjyqit, që mundëson mbajtjen e distancës, e cila duhet të jetë së paku 2 metra midis dy personave;
- ndalohet që palët të hyjnë dhe të qëndrojnë në sallën gjyqësore, nëse ato paraprakisht nuk janë të thirrur dhe nëse nuk është e nevojshme;
- hyrja e palëve në seancat e planifikuara dhe seancat kryesore do të kryhet sipas përparësisë dhe domosdoshmërisë për të marrë pjesë në gjykim, përparësi do të kenë palët në procedurë, përfaqësuesit e tyre, si dhe personat e tjerë të ftuar me ftesë gjyqësore;
- për praninë e personave të tjerë në sallat e gjykimit dhe në lidhje me zbatimin e masave të mbrojtjes vendos gjykatësi individual përkatësisht: këshilli i ngarkuar me çështjen;
- pas përfundimit të seancës, palët janë të detyruara menjëherë të largohen nga salla e gjykatës dhe godina e gjykatës, përkatësisht të kufizojnë në minimumin qëndrimin e tyre;

### 5. ZYRAT DHE KABINETET

- Vënia e detyrueshme e maskës mbrojtëse higjienike, e vënë siç duhet në fytyrë nëse në hapësirë ka më shumë se dy persona;
- mbajta e detyrueshme e distancës, e cila duhet të jetë së paku 2 metra midis dy personave;
- ajrosja e detyrueshme e hapësirave në mënyrë të natyrshme dhe dezinfektimi i sipërfaqeve të punës;
- ndalohet që palët të hyjnë dhe të qëndrojnë në këto hapësira nëse nuk janë thirrur më parë dhe nëse kjo nuk është e nevojshme;

### 6. MJETET SANITARE

- kur përdoren tualetet për palët që vijnë në godinën e gjykatës, caktohet një tualet, i cili duhet të jetë i vendosur në katin përderes ose në afërsi të tij;
- ajrosja e hapësirave në mënyrë të natyrshme dhe dezinfektimi i sipërfaqeve sanitare;